REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2638/4 Prot. Vlorë më, 01.10.2026

VENDIM

Nr. 53, datë 01.10.2026

PËR

RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR" NË INXHINIERI ELEKTRIKE, NË MASËN DERI NË 20%, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE, NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, nenit 38, pika 1, shkronja "dh", dhe nenit 75 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; nenit 10, pika 6, dhe nenit 19, pika 1, shkronja "ë", të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; Udhëzimit nr. 1 të MAS, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve"; VKM-së nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", e ndryshuar; si dhe referuar propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmëse Akademike, përcjellë me shkresën nr. 2582/1 prot., datë 01.10.2026, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 01.10.2026,

VENDOSI

1. Të miratojë riorganizimin, deri në masën 20%, të Programit të Studimit të Ciklit të Parë "Bachelor" në Inxhinieri Elektrike, në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, sipas dokumentacionit bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse të tij.

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288
Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al

1. Ndryshime në kredite dhe ristrukturim i lëndëve:

1. Lënda "Analizë matematike 1" dhe lënda "Analizë matematike 2", nga 6+6 kredite, të riorganizohet në "Analizë matematike" me 12 kredite.
2. Lënda "Fizikë 1" dhe lënda "Fizikë 2", nga 6+6 kredite, të riorganizohet në "Fizikë" me 12 kredite.
3. Lënda "Hyrje në programim" nga 6 kredite riorganizohet në "Bazat e Informatikës Inxhinierike" me 6 kredite.
4. Lënda "Bazat e Elektronikës" nga 6 kredite riorganizohet në "Bazat e Inxhinierisë Elektrike" me 6 kredite.
5. Lënda "Bazat e Inxhinierisë Termike" nga 6 kredite riorganizohet në "Fizikë Teknike" me 6 kredite.
6. Lënda "Teknologji mekanike" nga 6 kredite riorganizohet në "Teknologji Mekanike 1" me 6 kredite.
7. Lënda "Anglisht 1" dhe lënda "Anglisht 2" nga 6+3 kredite riorganizohen në "Anglisht/Italisht" me 3 kredite.
8. Lënda "Tezë diplome/Provim Formimi" nga 6 kredite riorganizohet në "Tezë Diplome" me 4 kredite.

Totali i krediteve të ndryshuara: 18 kredite, që përbën 10% të programit total (180 kredite), brenda kufirit të lejuar deri në 20%.

2. Ndryshime organizative në shpërndarjen e lëndëve sipas viteve akademike:

Nuk ka ndryshime në shpërndarjen e lëndëve sipas viteve akademike. Lëndët e vjetra të cilat janë riorganizuar në lëndë të reja zhvillohen në të njëjtin vit si në programin e vjetër.

3. Rishpërndarja sipas kategorive të veprimtarive formuese (në përputhje me Shtojcën nr. 1 të nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"):

1. Kategoria A – Lëndët bazë: 20% nuk ka ndryshime.
2. Kategoria B – Lëndë karakterizuese: nga 52.7% bëhet 50%.
3. Kategoria C – Lëndë ndërdisiplinore: 13.33% nuk ka ndryshime.
4. Kategoria D – Lëndë plotësuese: nga11.7% bëhet 14.4%.
5. Kategoria E – Diplomë/Provim përfundimtar: nga 2.3% nuk ka ndryshime.

3. Bashkëlidhur këtij vendimi është plani mësimor i riorganizuar, i cili është pjesë përbërëse e tij.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektori Akademik, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore dhe Drejtoria e Shërbimeve Ndihmëse Akademike.
5. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet për dijeni Ministrisë së Arsimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Aurela Saliaj